



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina



EKSTRAKTI I PROCESVERBALIT

**të mbledhjes së tetë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, e mbajtur më 15.10.2015,
e cila filloi në orën 10:00.**

Në mbledhje morën pjesë: Halim Halimi, kryesues i Kuvendit, Shpend Ahmeti, Kryetar i Komunës, Dardan Sejdiu, nënkryetar i Komunës, këshilltarët e Kuvendit: Sami Hamiti, shef i GP-së (LDK), Hazir Borovci (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Vlora Dumoshi (LDK), Agim Gashi (LDK), Shefki Gashi (LDK), Shaip Hajrizi (LDK), Naime Osmani (LDK), Vjollca Dibra - Ibrahimimi (LDK), Besa Rafuna (LDK), Ajnishahe Azemi (LDK), Hasime Krasniqi (LDK), Merita Surkishi (LDK), Flamur Shala (LDK), Abit Kastrati (LDK), Shiqeri Spahiu (LDK), Sylejman Pireva (LVV), Genc Sherifi (LVV), Teuta Krasniqi (LVV), Bardha Dida - Rogova (LVV), Hatixhe Hoxha (LVV), Hatixhe Latifi - Pupovci (LVV), Qëndron Kastrati, shef i GP-së (LVV), Kreshnik Ahmeti (LVV), Sadri Ramabaja (LVV), Lirak Çelaj, shef i GP-së (PDK), Shemsi Veseli (PDK), Lirijeta Rexhepi (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Laura Zherka (PDK), Islam Pacolli, shef i GP-së (AKR), Remzi Pacolli (AKR), Mirlinda Sopi (AKR), Sofije Bunjaku (AKR), Imer Rusinovci, shef i GP-së (AAK-LDD), Rita Begolli (AAK-LDD), Fadil Gashi (AAK-LDD), Abetare Fazliu (LB), Feti Mehdiu, shef i GP-së (PD), Kimet Zeqa (PD), Visar Arifaj, përfaqësues i subjektit politik (PF) dhe Nenad Miladinoviçi, përfaqësues i subjektit politik (GIS).

Munguan: Sokol Krasniqi (LDK), Ylli Hoxha (LVV), Blerand Stavileci (PDK), Shaip Shabani (PDK), Lirie Avdiu (PDK), Brahim Mehmetaj, shef i GP-së (LB) dhe Cuneyd Ustaibo, përfaqësues i subjektit politik (KDTP).

Morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive të Komunës, përfaqësues të Ministrisë së Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike dhe përfaqësues të OSBE-së.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Halim Halimi**, kryesues, dhe propozoi këtë

R E N D D I T E:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së shtatë të Kuvendit;
2. Propozimvendimi për miratim-lënie në dispozicion për diskutim publik të Planit rregullues të lagjes "Mati 2";
3. Propozimvendimi për miratimin e plotësimit dhe ndryshimit të Planit rregullues të lagjes "Sofalia";
4. Pripozimvendimi për fillimin e ndryshimit dhe plotësimit të Planit rregullues të lagjes "Tophane";
5. Propozimvendimi për fillimin e ndryshimit dhe plotësimit të Planit rregullues "Dodona";
6. Propozimvendimi për fillimin e ndryshimit dhe plotësimit të Planit rregullues të lagjes "Qyteza Pejton";
7. Propozimvendimi për miratimin - lënie në dispozicion për diskutim publik të Planit rregullues të lagjes "Kodra e Trimave 1";
8. Propozimvendimi për miratimin - lënie në dispozicion për diskutim publik të Planit rregullues të lagjes "Kalabria";
9. Propozimvendimi për fillimin e ndryshimit dhe plotësimit të Planit rregullues të lagjes "Mati 1";
10. Propozimvendimi për dhënien e pëlqimit për ndryshime në infrastrukturë në një pjesë të Planit rregullues të lagjes "Lakërishta" në Prishtinë;
11. Rikategorizimi i parkut regjional natyror "Gërmia" në kategori - Peizazh i mbrojtur "Gërmia";
12. Propozimrregullorja për organizimin e punës në shkolla fillore të mesme të ulëta dhe të mesme të larta;
13. Caktimi i komisionit për përzgjedhjen e kryetarëve të Bashkësive lokale;
14. Propozimvendimi për formimin e grupit punues për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për bashkësi lokale;
15. Pyetje dhe përgjigje;
16. Të ndryshme.

Kryesuesi hapi diskutimin rreth rendit të ditës.

Sami Hamiti, në emër të GP të LDK-së, bëri vërejtje rreth pikave të rendit të ditës, e që realisht në mbledhjen e KPF-së ka qenë një kërkesë nga dy grupet e mëdha parlamentare, që në këtë seancë të jenë pikat e rendit të ditës që janë obligim ligjor, dhe vijnë sipas kërkesave ligjore për Kryetarin e Komunës, të cilat janë: Raporti i Auditorit të Përgjithshëm, i cili është dashur të diskutohet në Kuvend në mbledhjen e muajit korrik; Raporti për punën gjashtëmujore, i cili është dashur po ashtu të diskutohet në mbledhjen e muajit korrik, dhe është obligim ligjor që Kryetari të raportojë për punën nëntëmujore.

Pra, shihet se asnjë nga këto pika nuk është futur në rend dite të kësaj mbledhje të Kuvendit.

Marrë parasysh të gjitha këto, z. kryesues dhe z. kryetar, në emër të GP të LDK-së kërkojmë që këto pika të vijnë sa më shpejt dhe të trajtohen.

Duke pasur parasysh vërejtjet që u ceken, si Grup parlamentar nuk do të jemi tutje prezent në këtë mbledhje.

Lirak Çelaj, në emër të GP të PDK-së, bëri të ditur se e përkrahin qëndrimin e GP të LDK-së, ndërsa për pikat e tjera që vijnë nga Urbanizmi, është diskutuar dhe gojarisht na është thënë që ka mundësi që këto të zhvendosen dhe të vijnë nga një drejtori tjetër, por kështu si janë, me të vërtetë na duket sikur një mashtrim optik. Është edhe një pikë tjetër e rendi të ditës, për të cilën më është dhënë premtim nga nënkryetari z. Sejdiu, që ka të bëjë me parcelën për varreza dhe për kishën protestante, e cila përkundër premtimeve që do të na silltet me ndonjë propozim alternativ ose që do të vije nga ekzekutivi, nuk ka ardhur, prandaj edhe ne do të insistojmë që kjo të futet në rendin e ditës.

Edhe ne si Grup parlamentar, nuk do të jemi pjesë e vazhdimit të kësaj seance.

Kimet Zeqa, në emër të Grupit të grave asamblastë, ngriti një kërkesë, që në rend të ditës të parashihet edhe iniciativa e Grupit të grave për ndërtimin e një objekti për kategoritë e personave me sindrom daun dhe autizëm.

Shpend Ahmeti, Kryetar i Komunës, theksoi se është më se e qartë sipas ligjit, i cili tregon se si duhet të raportojë Kryetari ndaj Kuvendit të Komunës. Këtë obligim ligjor unë e kam kryer kur ua kam dërguar Raportin e punës gjashtëmujore dhe Raportin e Auditorit. Sipas obligimit ligjor, do ta dorëzojmë edhe Raportin nëntëmujor financiar. Sa i përket organizimit të drejtorive komunale, ideja e ekzekutivit ka qenë që ta ndajmë planifikimin nga lejet, sepse kështu e kanë edhe shumë qytete të tjera.

Për kërkesën e Lirakut rreth ndarjes së lokacionit për varrezat dhe kishën protestante, nuk mund të marrim ndonjë vendim pa e diskutuar dhe trajtuar në Kuvend.

Pas diskutimeve, GP i LDK-së dhe GP i PDK-së e lëshuan mbledhjen.

Kryesuesi konstatoi se në mungesë të kuorumit, mbledhja nuk mund të vazhdohet, andaj dhe kërkoi një takim paraprak me Kryetarin, nënkryetarin dhe shefat e GP-ve, në mënyrë që ta caktojnë mbledhjen e ardhshme me këto pika të rendit të ditës.

Mbledhja u ndërpre në orën 11:45.

Procesmbajtësi
Zijadin Gashi

Kryesuesi i Kuvendit
Halim Halimi, jur. i dipl.

Faqe 3 nga 3